



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 2557/5 Prot.

Tiranë, më 20/08/2019

UDHËZIM

Nr. 6, Datë 20/08/2019

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E KRYERJES SË PAGESAVE TË SHPENZIMEVE GJYQËSORE, PËR TË CILAT ËSHTË VENDOSUR PËRJASHTIMI NË RASTIN E DHËNIES SË NDIHMËS JURIDIKE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 7, germa “gj” dhe nenit 28, pika 4, të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ministri i Drejtësisë,

U D H Ë Z O N:

1. Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi, në kuptim të ligjit nr. 111/2017, datë 14.12.2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.
2. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas kryen pagesat e shpenzimeve për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend, sipas përcaktimeve të legjisllacionit procedural, për të cilat gjykata ka vendosur përjashtimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore.
3. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas kryen pagesat bazuar në vendimin gjyqësor, sipas përcaktimeve të udhëzimit nr. 4, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve gjatë procesit gjyqësor” i ndryshuar .
4. Brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e shpalljes të vendimit nga gjykata për përjashtimin nga pagesat e shpenzimeve gjyqësore, dëshmitari, eksperti dhe përkthyesi paraqesin pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dokumente tatimore për shërbimet e ofruara dhe, sipas rastit, dokumentacionin vërtetues, si vijon:
 - a) dokumentin tatimor për shpenzimet e transportit;
 - b) dokumentin tatimor për shpenzimet e fjetjes;
 - c) dokumentin me karakter vërtetues të vendit të punës dhe vlerës së pagës;

ç) vërtetim bankar nga një bankë e nivelit të dytë për deklarimin e numrit të llogarisë në lekë.

5. Mosparaqitja e dokumentit tatimor nga ana e dëshmitarit, ekspertit dhe përkthyesit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për tatimet përbën shkak për mos kryerjen e pagesave për shërbimet e ofruara dhe për të cilat është vendosur përjashtimi nga shpenzimet gjyqësore.

6. Në fund të çdo muaji, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, harton një raport mbi vendimet gjyqësore të njoftuara, dokumentet tatimore të paraqitura për secilin vendim, përlllogaritjen e shpenzimeve ditore dhe buxhetin në dispozicion për pagesën e tyre. Bazuar në këtë analizë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas kryen pagesat e shpenzimeve gjyqësore, sipas radhës kronologjike të vendimeve gjyqësore të njoftuara dhe të plotësuara me dokumentacionin provues.

7. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas njofton dëshmitarin, ekspertin, përkthyesin, gjykatën që ka dhënë vendimin dhe përfituesin e ndihmës juridike dytësore të garantuar nga shteti, të cilin i është pranuar kërkesa për përjashtimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, për kryerjen e pagesës së shpenzimeve gjyqësore.

- Njoftimi shoqërohet me një kopje të vërtetimit të dhënë nga banka që vërteton kryerjen e pagesës.

- Njoftimi bëhet brenda 5 (pesë) ditëve nga kryerja e pagesës, në rrugë postare, elektronike si dhe me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi

8. Në rastin kur limiti mujor është i pamjaftueshëm për likuidimin e plotë të shpenzimeve gjyqësore, likuidimi shtyhet në muajin pasardhës, sipas radhës kronologjike të vendimeve gjyqësore të njoftuara dhe të plotësuara me dokumentacionin tatimor provues.

9. Në rast të mungesës së fondeve buxhetore për pagesën e të gjitha shpenzimeve gjyqësore të përlllogaritura, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas duhet të kontabilizojë çdo detyrim të mbartur, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe të planifikojë fondet e nevojshme për shlyerjen e këtyre detyrimeve, për periudhat e ardhshme buxhetore.

10. Ngarkohet Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Etilda Gjohaj (Saliu)

